



02 /Nr. 6751 /2020  
Data: 22.09.2020

## PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK

Mbajtur me datë 16.09.2020 në ora në ora 14:00. Dëgjimi publik për shkak të situatës me pandeminë e korona virusit u organizua në formë virtuale përmes platformës facebook.

Takimin e kryesoj Kryesuesi i Kuvendit z.Qamush Brava.

### Rendi i Punës

#### 1. Hartimi i Projekt Buxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2022-2023.

**Qamush Brava** të nderuar qytetarë për hir të transparencës dhe me qëllim të marrjes së kërkesave të qytetarëve për projektet që do të realizohen në vitet vijuese kemi thirr këtë takim virtual në pamundësi të takohemi fizikisht për shkak të pandemisë. Siç ju kemi njoftuar komentet dhe propozimet e juaja keni pasur mundësi me i paraqitur dhe mund ti paraqitni deri në miratimin e buxhetit që do të bëhet nga kuvendi deri me datë 30.09.2020. Ftesën për këtë datë e kam bërë duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 68 , statutin e komunës 79. Me datë 26.08.2020 jemi njoftuar nga Ministria e Financave që mos me u proceduar në kuvendin e komunës buxheti komunal për disa ditë deri sat ë pranohet nga Ministria e Financave Qarkorja e tretë buxhetore për vitin 2021-2023. Me datë 14.09.2020 nga Ministria e Financave ekzekutivit të komunës ju është dërguar qarkorja e tretë buxhetore me kufijtë final që presim nga ekzekutivi i komunës që ta dërgon në kuvendin e komunës. Të nderuar qytetarë të komunës së Hanit të Elezit kërkoj nga ju që ti jepni propozim projektet e juaja për vitin 2021. Propozimet do të përcillen në asamblenë komunale për shqyrtim dhe miratim. Kërkesat e qytetarëve janë ndoshta të mëdha kurse buxheti është i limituar por do të mundohemi që kërkesat dhe propozimet e juaj ti shqyrtojmë. Duke mos pasur mundësi që secilit të i përgjigjemi në komente propozimet e juaja do të procedohen në kuvend.

**Shabi Rexhallari** buxheti i komunës se Hanit të Elezit i caktuar për vitin 2021 do të jetë në lartësi prej 2,520,166 €, Për vitin 2022 buxheti do të jetë në shumë prej 3,102,887 €, ndërsa buxheti i vitit 2023 do të jetë në shumë prej 3,194,754 €.

**Faruk Berisha** të bëhet zgjidhje sa më parë me ujin e pishëm në fshatin Gorancë sepse jemi me një gjendje të rëndë. Të rregullohet kanalizimi në pjesën tjetër të fshatit në anën e djathtë. Rregullimi i pishinës për rinin e fshatit. Mundësisht me bashkëpunuar me KEDS-in për me lidh rrjetin e rrymës në rrjetin e Achro në rrugën e Hunelve

**Vjosa Livoreka** propozimi im është tek pronat të cilat janë, në emër të Komunës së Hanit të Elezit (respektivisht në afërsi të çerdhes),te bëhet rirregullimi i hapësirës gjelbëruese, dhe ndriçimi publik për skaj shtigjeve këmbësore, për një ambient më të mirë, për qytetarët të cilët po janë numër i shumë në qëndrimin pasditor për relaksim dhe aktivitet sportiv.

**Vaid Daci** të bëhet rigjallërimi i botës nën ujore në lumin Lepenc, të ndiqet shembulli i komunës së Pejës dhe komunës së Shtimes, Propozimi-2 Të bëhet ndriçimi publik në rrugën (tretuarin) përgjatë Hekurudhës nga Ura e Fejzes deri te Ura e Seçishtës. (edhe pse disa herë e kemi bërë këtë kërkesë na është thënë se do të punohet në hekurudhë...!!! Por sipas të gjitha informatave në Hekurudhë do të punohet veten në gjendjen ekzistuese dhe nuk do të ketë zgjerime).

**Refedin Curri** kërkoj që rruga Dremjak që është përfunduar te trafoja e rrymës elektrike të vazhdohet deri te shtëpia e fundit e fshatit Dremjak .


**Shefki Thaçi** propozoj që rruga Krivenik - Gorancë të asfaltohet.

**Qamush Brava** krahas propozimeve të dhëna , qytetarët e kanë mundësin me dhënë propozime deri para miratimit të buxhetit.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 14:30 .

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**

